



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu  
Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 1/953

Datë: 21 / 8 / 2025

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 12, paragrafit 1, nenit 14, paragrafit 2, nenit 39 dhe nenit 45 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, mbështetur në dispozitat e nenit 19, pikat 1, 2, 3 dhe nenit 28, pika 1, nënpika 1.1, të Rregullores së punës nr. 280 të datës 13.2.2025, më 19.08.2025, miratoi:

### RREGULLOREN PËR PARIMET E PUNËS DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTEVE DHE QENDRAVE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

##### Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë procedurat e themelimit dhe menaxhimit të instituteve dhe qendrave që veprojnë në kuadër të Universitetit të Prishtinës në nivel qendror ose në nivel të njësisë akademike. Rregullorja gjithashtu përcakton parimet e funksionimit, organizimin e brendshëm dhe autonominë operationale të

instituteve/qendrave. Përmes kësaj rregulloreje synohet orientimi i Universitetit të Prishtinës drejt realizimit të misionit të tretë të universitetit, përkatësisht kontributit të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, përfshirë edhe nxitjen e ndërmarrësisë të personeli akademik, studentët dhe komuniteti i gjerë.

## **Neni 2**

### **Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha institutet dhe qendrat e themeluara në kuadër të Universitetit të Prishtinës, në nivel qendror ose të njësisive akademike, të cilat veprojnë në fushat e kërkimit shkencor, zhvillimit profesional, ofrimit të shërbimeve konsulente dhe trajnuese, si dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërdisiplinor, ndërinstytucional dhe ndërkombëtar, në përputhje me Statutin e UP-së dhe legjislacionin në fuqi. Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejné edhe për galeritë dhe teatrot e UP-së.

## **Neni 3**

### **Natyra e funksionimit të instituteve dhe qendrave**

1. Institutet/qendrat — në nivel qendror apo të njësisive akademike të UP-së — janë të inkuorporuara në strukturën e universitetit dhe/apo njësisë akademike dhe gëzojnë autonomi veprimi sipas ligjeve në fuqi.
2. Institutet/qendrat (qendrore apo të njësisive akademike) nuk kanë subjektivitet juridik, por konsiderohet se atyre u janë deleguar kompetencat në fushën e kontraktimit, menaxhimit financiar, raportimit në ndërlidhje me donacionet, grantet hulumtuese, vetëfinancimin dhe autorizimet që parashihen me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë statutin dhe këtë rregullore.
3. Qëllimi kryesor i instituteve/qendrave është zhvillimi i hulumtimeve shkencore në fusha me rëndësi strategjike për universitetin dhe shoqërinë si dhe zhvillimin e hulumtimeve që kanë karakter ndërdisiplinor dhe jo vetëm. Institutet/qendrat kanë të drejtë të shfrytëzojnë infrastrukturën fizike dhe shkencore të Universitetit të Prishtinës, në përputhje me rregulloret në fuqi në UP, dhe mund të ofrojnë edhe shërbime konsulente dhe komerciale për sektorin privat.
4. Në raste të veçanta, UP-ja mund të krijojë institute/qendra me përkrahjen apo në partneritet me institucione të jashtme. Këto institute apo qendra mund të themelohen si pjesë e programeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme vendore apo ndërkombëtare, ose në kuadër të projekteve kërkimore e zhvillimore, nëse ato janë në interes të UP-së dhe në përputhje me prioritetet dhe strategjitë kombëtare.

## **Neni 4**

### **Qëllimi dhe fushëveprimtaria e instituteve dhe qendrave**

1. Qëllimi dhe fushëveprimtaria e instituteve/qendrave përfshin, por nuk kufizohet në:
  - 1.1. Zhvillimin dhe zbatimin e projekteve shkencore dhe hulumtuese, në mënyrë vetanake dhe/apo në bashkëpunim me institucione apo organizata vendore dhe ndërkombëtare;
  - 1.2. Ofrimin e shërbimeve profesionale dhe konsulente;
  - 1.3. Realizimin e aktiviteteve mësimore dhe trajnuese;
  - 1.4. Nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarive artistike dhe kulturore.
2. Institutet/qendrat obligohen të hartojnë strategji për tërheqjen e fondeve, realizimin e aktiviteteve dhe shfrytëzimin e rezultateve akademike, shkencore dhe artistike në funksion të misionit të UP-së.

## **II. THEMELIMI DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM**

### **Neni 5**

#### **Inicimi dhe procedurat për themelimin e instituteve dhe qendrave**

1. Kërkesa për themelim të institutit/qendrës në nivel qendror inicohet në Këshillin Drejtues nga rektori.
2. Kërkesa për themelim të institutit/qendrës në njësi akademike adresohet fillimisht në këshillin e njësisë akademike. Më pas, kërkesa për themelim të institutit/qendrës në nivel të njësisë akademike paraqitet në Këshillin Drejtues nga rektori.
3. Kërkesa për themelim të institutit/qendrës nga rektori, apo njësi akademike, duhet të ketë një arsyetim të detajuar, i cili duhet të jetë në përputhje me këtë rregullore.
4. Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës vendos përfundimisht për kërkesën për themelim të institutit/qendrës.
5. Pas pëlqimit për themelim të institutit/qendrës, Këshilli Drejtues, me propozim të iniciuesit, e miraton rregulloren e punës, e cila duhet të jetë në harmoni me këtë rregullore dhe rregulloret e tjera në fuqi.
6. Pas miratimit të kërkesës nga KD-ja dhe miratimit të rregullores së punës së institutit/qendrës përkatëse, njësi akademike mund të procedojë me zgjedhjen e organeve të institutit/qendrës, përkatësisht zgjedhjen e këshillit të institutit/qendrës.

7. Institutet/qendrat ekzistuese duhet t'i harmonizojnë rregulloret e punës me këtë rregullore dhe të njëjtat të dorëzohen për miratim në Këshillin Drejtues të UP-së, brenda afatit prej 60 ditësh pas miratimit të kësaj rregulloreje.

## **Neni 6**

### **Struktura organizative**

1. Organet e institutit/qendrës janë:
  - 1.1. Këshilli i institutit/qendrës;
  - 1.2. Drejtori;
  - 1.3. Personeli mbështetës, sekretari, etj.;
2. Në rast të zgjerimit të veprimtarisë dhe angazhimeve të institutit/qendrës, Këshilli Drejtues i UP-së, me kërkesë të arsyetuar, mund të aprovojë zgjerimin e strukturës organizative.
3. Në rast se drejtori dhe personeli mbështetës synojnë të angazhohen jashtë Universitetit të Prishtinës, angazhimi i tyre duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë.

## **Neni 7**

### **Këshilli i institutit/qendrës**

1. Këshilli i institutit/qendrës ka për detyrë përcaktimin e strategjive kërkimore dhe zhvillimore, ofrimin e udhëzimeve për avancimin e veprimtarive kërkimore, si dhe mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Këshilli kontribuon në forcimin e bashkëpunimit me institucionet akademike, shkencore, artistike, sportive dhe profesionale, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
2. Këshilli i institutit/qendrës në nivel të UP-së përbëhet nga pesë (5) anëtarë, të cilët caktohen nga rektori:
  - 2.1. Tre (3) anëtarë duhet të jenë nga personeli i rregullt akademik i UP-së ose bashkëpunëtorë të jashtëm akademikë të UP-së, që kanë përvojë me fushëveprimin e institutit/qendrës dhe përfaqësojnë njësi të ndryshme akademike.
  - 2.2. Dy (2) përfaqësues të nominuar nga palët e interesit dhe/ose donatorët.
3. Këshilli i institutit/qendrës në nivel të njësisë akademike përbëhet nga pesë (5) ose shtatë (7) anëtarë si në vijim:
  - 3.1. Një përfaqësues i caktuar nga rektori i UP-së;
  - 3.2. Një përfaqësues i caktuar nga dekani i njësisë akademike;

- 3.3. Shefi i departamentit përkatës (nëse instituti/qendra mbështetet në më shumë departamente, dekani i njësisë emëron një përfaqësues);
  - 3.4. Një anëtar i personelit akademik, i zgjedhur nga departamenti përkatës (ose në rast të përfshirjes së më shumë departamenteve, i zgjedhur nga këshilli i njësisë akademike);
  - 3.5. Një ose tre anëtarë të jashtëm nga komuniteti akademik, profesional, sektori i biznesit apo ndërmarrësisë, nga Kosova apo jashtë saj. Anëtarët e jashtëm propozohen dhe miratohen nga këshilli i njësisë akademike përkatëse.
4. Në rastet kur instituti/qendra themelohet në partneritet me palë të treta, menaxhmenti i UP-së kërkon që institucioni partner të delegojë përfaqësues në këshillin e institutit/qendrës. Megjithatë, numri i përfaqësuesve të Universitetit të Prishtinës në këtë këshill duhet të jetë gjithmonë më i madh se numri i përfaqësuesve të institucioneve partnere.
  5. Mandati i anëtarëve të këshillit është katër (4) vjet, me mundësi riemërimi vetëm edhe për një mandat.
  6. Në mbledhjen e parë konstituive, këshilli e zgjedh kryesuesin nga radhët e veta.
  7. Kryesuesi thërret dhe udhëheq mbledhjet e këshillit, të cilat duhet të mbahen së paku 3 herë në vit.
  8. Vendimet në këshill merren me shumicë votash të anëtarëve me të drejtë vote.
  9. Drejtori i institutit/qendrës është anëtar i këshillit ex-officio, pa të drejtë vote.
  10. Me propozimin e drejtorit, këshilli i institutit/qendrës miraton listën e ekspertëve të jashtëm për angazhim në ofrimin e shërbimeve.

## **Neni 8**

### **Drejtori i institutit/qendrës**

1. Instituti/qendra udhëhiqet nga drejtori, i cili është përgjegjës për:
  - 1.1. menaxhimin e aktiviteteve kërkimore, edukative dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara;
  - 1.2. menaxhimin efektiv të burimeve financiare, pajisjeve dhe resurseve njerëzore, duke siguruar transparencë dhe përdorim efikas të këtyre burimeve;
  - 1.3. përcaktimin e prioriteteve kërkimore dhe bashkëpunimin me grupe të tjera kërkimore brenda universitetit dhe me palë të treta (p.sh. industri) për zhvillimin e projekteve të përbashkëta.
2. Drejtori zgjidhet nga këshilli, me mandat katërvjeçar dhe mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat.

3. Drejtori mund të jetë nga radhët e personelit të rregullt akademik të Universitetit të Prishtinës, apo të emërohet edhe nga jashtë universitetit, nëse posedon ekspertizë të dëshmuar përkitazi me fushëveprimtarinë e institutit/qendrës dhe përvojë menaxheriale.
4. Në kryerjen e detyrave të tij, drejtori përkrahet nga personeli mbështetës i institutit/qendrës.
5. Drejtori është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të institutit/qendrës.

## **Neni 9**

### **Personeli mbështetës**

1. Në kuadër të burimeve njerëzore, instituti apo qendra mund të ketë personel mbështetës, i cili kontribuon në funksionimin e institutit/qendrës. Personeli mbështetës përfshin pozita që mbulojnë shërbimet administrative, teknike dhe menaxheriale, në përputhje me nevojat e veçanta të institutit apo qendrës.
2. Varësisht nga fusha e veprimtarisë së institutit/qendrës, drejtori mund të emërojë udhëheqësit e njësisë të specializuara hulumtuese ose strukturave tematike, në përputhje me fushat përkatëse të veprimtarisë shkencore dhe akademike të institutit/qendrës, duke u bazuar në kërkesat e veprimtarisë dhe misionit të institutit/qendrës. Udhëheqësit e njësisë hulumtuese zgjidhen në bazë të ekspertizës së tyre, si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe aktet përkatëse të Universitetit të Prishtinës.
3. Personeli mbështetës propozohet nga drejtori dhe miratohet nga këshilli i institutit/qendrës, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet përkatëse të Universitetit të Prishtinës.
4. Sekretari mund të jetë nga radhët e personelit akademik të UP-së, njësisë akademike përkatëse, departamentit apo të zgjidhet edhe nga jashtë universitetit, nëse posedon ekspertizë të dëshmuar përkitazi me fushëveprimtarinë e institutit/qendrës dhe përvojës menaxheriale.
5. Sekretari kryen punët administrative dhe mbikëqyr administratën e brendshme të institutit/qendrës, si dhe siguron që veprimtaritë administrative të funksionojnë në përputhje me rregulloret dhe procedurat e universitetit.
6. Sekretari i përgjigjet drejtorit dhe është përgjegjës për organizimin e takimeve, dokumentacionit dhe mbajtjen e shënimeve të institutit/qendrës, si dhe detyrave tjera që i caktohen nga drejtori.

## **Neni 10**

### **Krijimi i njësive hulumtuese**

1. Instituti/qendra që funksionon në kuadër të një fakulteti përbëhet nga trupa profesionale, të përbëra nga personeli akademik dhe kërkimor, të cilët kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e projekteve kërkimore, shkencore, artistike, sportive dhe profesionale.
2. Për të avancuar agjendën kërkimore dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërdisiplinor brenda njësive akademike, instituti/qendra mund të krijojë njësi hulumtuese (grupe punuese), të përbëra nga ekipe të personelit akademik.
3. Po ashtu, instituti/qendra ka të drejtë të formojë njësi të specializuara hulumtuese ose struktura tematike, në përputhje me fushat përkatëse të veprimtarisë së saj shkencore dhe akademike.
4. Krijimi, organizimi, funksionimi dhe fushëveprimi i këtyre njësive përcaktohen me rregullore të brendshme të institutit/qendrës.

## **III. FINANCIMI DHE BURIMET E FINANCIMIT**

### **Neni 11**

#### **Burimet e financimit**

1. Institutet/qendrat me interes të veçantë<sup>1</sup>, për qëllime të financimit nga buxheti i Republikës së Kosovës, trajtohen si programe të veçanta brenda strukturës organizative të Universitetit të Prishtinës. Universiteti i Prishtinës është organizatë buxhetore, në përputhje me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, dhe përbëhet nga njësi dhe programe të ndryshme buxhetore, përfshirë edhe institutet dhe qendrat e tij.
2. Aktivitetet e instituteve/qendrave financohen nga burimet e mëposhtme:
  - 2.1. Fondet publike, përfshirë financimin nga UP-ja, vetëm për institutet/qendrat me interes të veçantë për UP-në, si p.sh. Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie;
  - 2.2. Projektet e financuara nga donatorë vendorë apo ndërkombëtarë;
  - 2.3. Aktivitetet vetanake që gjenerojnë të hyra;

---

<sup>1</sup> Institutet dhe qendrat me interes të veçantë janë ato institucione që themelohen me përkrahje konkrete institucionale dhe/ose financiare nga Universiteti i Prishtinës, institucionet shtetërore ose partnerë strategjikë dhe janë pjesë e projekteve me interes strategjik për Universitetin e Prishtinës dhe interes kombëtar për Republikën e Kosovës.

2.4. Donacionet;

2.5. Çdo burim tjetër i ligjshëm financimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin e UP-së dhe aktet e tjera të nxjerra nga UP-ja.

3. Në kuptim të paragrafit 2, nënparagrafit 2.1. të këtij neni, një institut/qendër merr atributin „me interes të veçantë” për UP-në bazuar në një analizë të detajuar profesionale, të përgatitur nga një ekip prej pesë mësimitdhënësve të fushës që përkon me veprimtarinë e qendrës. Për këtë vendos përfundimisht Këshilli Drejtues i UP-së.

## **Neni 12**

### **Nënlllogaritë/kodet programore dhe menaxhimi i tyre**

1. Institutet/qendrat operojnë me nënlllogari/kode programore në kuadër të llogarisë së UP-së.
2. Në përputhje me dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe të Ligjit për Arsimin e Lartë, institutet/qendrat kanë të drejtë të kenë llogari/nënlllogari/kode programore bankare, të menaxhuara nga vetë instituti apo qendra. Kjo llogari/nënlllogari/kod programor mund të përdoret për të hyrat vetanake, projektet e donatorëve, grantet dhe donacionet, të cilat nuk burojnë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Hapja, mbajtja dhe raportimi për të hyrat dhe shpenzimet në këtë llogari/nënlllogari/kod programor janë përgjegjësi e drejtorit të institutit/qendrës dhe duhet të jenë pjesë e planifikimit dhe raportimit të rregullt të institutit/qendrës.
3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, çdo e hyrë dhe shpenzim i kryer nga të hyrat duhet të jetë në përputhje me procedurat që zbaton Universiteti i Prishtinës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe të jetë pjesë e raportimeve të rregullta të institutit/qendrës.
4. Universiteti i Prishtinës realizon të gjitha aktivitetet e prokurimit për njësitë përbërëse, përfshirë edhe institutet/qendrat dhe njësitë e tjera organizative në kuadër të tij.

## **Neni 13**

### **Planifikimi financiar dhe ndarja e mjeteve**

1. Pagesa për punët e kryera bëhet në përputhje me rregulloret përkatëse të Universitetit të Prishtinës (UP).
2. Ndarja e mjeteve financiare do të bëhet në varësi të natyrës së projektit, kontratës, nëse bëhet fjalë për projekt shkencor ose për shërbime që instituti/qendra ofron për palët e tjera.

3. Zbatimi i *projekteve*<sup>2</sup> dhe ndarja e fondeve bëhet në përputhje me përshkrimin e projekt-propozimit të aprovuar nga donatori. Mënyra e zbatimit të projekteve brenda UP-së rregullohet sipas „Rregullores për zyrën për kërkime dhe programe të sponsorizuara” dhe sipas „Rregullores për menaxhimin e projekteve me financim të jashtëm”.
4. Për *shërbimet*<sup>3</sup> që institutet/qendrat ofrojnë për palët e treta, në kuadër të shpenzimeve duhet të parashihen të gjitha kostot e nevojshme për realizim të punëve dhe shërbimeve, përfshirë edhe kosto indirekte, të cilat llogariten sipas formulës më poshtë:

Totali i mjeteve bruto të realizuara = **A**<sup>4</sup>

- a) Nëse shërbimet kryhen pa laborator **U** = minimumi 15% x A (5% për fakultetin dhe 10% për universitetin, përkatësisht minimumi 15% për universitetin nëse shërbimi kryhet në institut/qendër në nivel të UP-së.)
  - b) Nëse shërbimet kryhen me laborator **U** = minimumi 25% x A (5% për institutin/qendrën, 5% për fakultetin dhe 15% për universitetin, përkatësisht minimumi 25% për universitetin nëse shërbimi kryhet në institut/qendër në nivel të UP-së.)
  - c) Çmimorja e shërbimeve të institutit/qendrës përpilohet fillimisht nga drejtori, e cila më pas duhet të aprovohet edhe nga këshilli i institutit/qendrës. Çmimorja për shërbimet që ofron instituti/qendra duhet të jetë publike.
  - d) Pagesat e personelit të institutit/qendrës propozohen fillimisht nga drejtori dhe më pas duhet të aprovohen edhe nga këshilli i institutit/qendrës, duke u bazuar në rregulloret e UP-së dhe legjislacionin në fuqi.
5. Për shërbimet të cilat ofrohen falas nga instituti/qendra për personelin dhe studentët e UP-së, UP-ja obligohet t’i kompensojë ofruesit e shërbimeve sipas rregulloreve përkatëse.
  6. Tarifat për ekspertizat gjyqësore që kryhen individualisht ose në grupe nga profesorët apo nga institutet/qendrat janë të lira nga ndalja e përqindjes (%) për universitetin/fakultetin; rrjedhimisht, ato paguhen për ekspertët e angazhuar në lëndën gjyqësore.

<sup>2</sup> Në kuptimin e kësaj rregulloreje, *projektet* janë iniciativa të strukturuar me objektiva të qarta dhe afate të përcaktuara, që realizohen nga institutet/qendrat në funksion të zhvillimit shkencor, arsimor, teknologjik apo institucional, dhe që financohen nga burime të brendshme ose të jashtme.

<sup>3</sup> *Shërbimet* për palë të treta janë aktivitete profesionale që ofrohen nga institutet/qendrat ndaj subjekteve të jashtme publike ose private, me qëllim ofrimin e ekspertizës, analizave, trajnimeve apo konsulencave praktike, kundrejt kompensimit financiar, duke shfrytëzuar kapacitetet dhe njohuritë institucionale në shërbim të komunitetit dhe zhvillimit socio-ekonomik.

<sup>4</sup> **A** = Totali i mjeteve bruto të realizuara; **U** = mjete financiare të dedikuara për universitetin.

## **Neni 14**

### **Angazhimi i personelit**

1. Në kuadër të projekteve dhe shërbimeve që ofron, instituti/qendra mund të angazhojë:
  - 1.1. Personelin akademik dhe administrativ të rregullt të Universitetit të Prishtinës;
  - 1.2. Studentë të UP-së;
  - 1.3. Personel të jashtëm, përfshirë ekspertë të fushave përkatëse si dhe personel administrativ për maksimumi 120 ditë brenda vitit kalendarik ose sipas nevojave dhe specifikave të projektit, të cilët angazhohen me kontrata të veçanta për punë dhe detyra specifike apo sipas nevojave të projektit dhe kërkesave së institutit/qendrës.
2. Angazhimi i personelit të rregullt të UP-së bëhet si në vijim:
  - 1.1. në përputhje me përgatitjen e tyre profesionale, përmes përzgjedhjes nga listat e ekspertëve të njohur nga UP-ja.
  - 1.2. me kontratë të veçantë për shërbim dhe në përputhje me rregulloret përkatëse të UP-së.
3. Ky angazhim nuk konsiderohet pjesë e marrëdhënies ekzistuese të punës, por realizohet përmes kontratave të shërbimit ose detyrave specifike.
4. Kontraktimi i personelit të jashtëm realizohet përmes përzgjedhjes nga lista e bashkëpunëtorëve të jashtëm ose përmes thirrjes publike të hapur, në përputhje me procedurat transparente dhe kriteret e definuara qartë në thirrje publike.

## **Neni 15**

### **E drejta për të kontraktuar punë dhe shërbime**

1. Institutet/qendrat kanë të drejtë të lidhin kontrata me persona fizikë dhe juridikë, vendorë apo ndërkombëtarë, për qëllime kërkimore, akademike, këshillëdhënëse dhe profesionale, në përputhje me misionin dhe objektivat e tyre. Këto kontrata përfshijnë bashkëpunime akademike, realizim projektesh, ofrim shërbimesh apo angazhim ekspertësh.
2. Kontratat nënshkruhen nga drejtori i institutit/qendrës, si person i autorizuar me shkrim nga rektori i UP-së, brenda kufijve të përcaktuar të autorizimit. Çdo kontratë duhet të respektojë rregullat financiare, të prokurimit dhe të kontrollit të brendshëm të UP-së dhe të raportohet sipas procedurave ligjore në fuqi.
3. Nëse kontrata ka implikime që tejkalojnë kompetencat e drejtorit, ajo kërkon miratim paraprak nga rektori. Kontrata duhet të përmbajë së paku elementet e përcaktuara në nenet 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 16**

### **Shërbimet dhe llojet e tyre**

1. Shërbimet që institutet/qendrat ofrojnë për sektorin publik apo privat përfshijnë, por nuk kufizohen në:
  - 1.1. Kryerjen e hulumtimeve, analizave dhe studimeve të fizibilitetit për sektorin publik dhe privat;
  - 1.2. Ofrimin e mbështetjes teknike në hartim të dokumenteve planifikuese, të politikave dhe ligjore;
  - 1.3. Ofrimin e këshillave profesionale përmes qendrave, instituteve dhe njësive tjera të kontrolluara nga UP-ja;
  - 1.4. Ofrimin e ekspertizave në fushat përkatëse që mbulojnë njësitë e Universitetit të Prishtinës;
  - 1.5. Transferin apo dhënien në shfrytëzim të teknologjisë, patentat, licencat, markat tregtare dhe produktet tjera nga fusha e pronësisë intelektuale dhe industriale;
  - 1.6. Ofrimin e kurseve dhe trajnimeve për subjektet e sektorit publik dhe privat;
  - 1.7. Inkubatorët për zhvillimin e bizneseve/start up;
  - 1.8. Marrëveshje të tjera, përmes të cilave UP-ja mund të ofrojë shërbime për subjektet e sektorit privat apo publik, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.

## **Neni 17**

### **Definimi i të drejtave dhe detyrimeve me marrëveshje**

1. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve përcaktohen me marrëveshje, e cila do të lidhet ndërmjet institutit/qendrës dhe subjektit të sektorit publik apo privat.
2. Marrëveshja duhet, ndër të tjera, të përfshijë:
  - 2.1 fushën e shërbimeve që ofrohen;
  - 2.2 detyrat dhe përgjegjësitë e palëve;
  - 2.3 planin kohor të ofrimit të shërbimeve dhe produktet e qarta që duhet të ofrohen;
  - 2.4 definimin e çështjeve që ndërlidhen me pronësinë intelektuale;
  - 2.5 kushtet dhe afatet e pagesës;
  - 2.6 dispozitat që përcaktojnë qartë mundësinë e shkëputjes së marrëveshjes;
  - 2.7 mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes;
  - 2.8 ruajtjen e sekretit afarist dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
  - 2.9 çështjet e të drejtave autoriale;

- 2.10 dispozita tjera sipas nevojës dhe shërbimit specifik.
3. Instituti/qendra, me rastin e negocimit të kushteve të marrëveshjes për ofrim të shërbimeve, duhet të sigurojë që Universiteti i Prishtinës të ketë përfitim nga marrëveshja e tillë mbi bazën e një analize të kostos dhe benefitit.
  4. Me rastin e lidhjes së një marrëveshjeje për ofrim të shërbimeve në mes të Universitetit të Prishtinës, gjegjësisht institutit/qendrës, dhe një organizate tjetër buxhetore nga sektori publik aplikohen rregullat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike për Transferet me mallra dhe shërbime ndërmjet organizatave buxhetore, rrjedhimisht organizata tjetër buxhetore duhet të paguajë për shërbimet e tilla në bazë të kthimit të kostos.

#### **IV. RAPORTIMI DHE LLOGARIDHËNIA**

##### **Neni 18**

##### **Raportimi dhe llogaridhënia**

1. Në fillim të çdo viti kalendarik, drejtori i institutit/qendrës e prezanton raportin vjetor për vitin paraprak dhe planin vjetor të punës për vitin vijues para këshillit të institutit/qendrës.
2. Këshilli i institutit/qendrës miraton raportin vjetor dhe planin vjetor.
3. Në rastin e instituteve/qendrave të themeluara në nivel të njësisë akademike, pas miratimit nga këshilli i institutit/qendrës, drejtori i institutit/qendrës ia dorëzon fillimisht raportin vjetor të institutit/qendrës si dhe planin vjetor të miratuar nga këshilli i institutit/qendrës, dekanit të njësisë akademike, i cili më pas të njëjtat i procedon edhe te zyra e rektorit.
4. Në rastin e instituteve/qendrave të themeluara në nivel të universitetit, pas miratimit nga këshilli i institutit/qendrës, drejtori i institutit/qendrës e dorëzon raportin vjetor të institutit/qendrës si dhe planin vjetor të miratuar drejtpërsëdrejti te zyra e rektorit.

##### **Neni 19**

##### **Vlerësimi i performancës dhe auditimi**

1. Performanca e instituteve/qendrave vlerësohet mbi bazën e rezultateve të hulumtimit, botimeve shkencore, inovacioneve dhe ndikimit të tyre në shoqëri.

2. Në rastin e instituteve/qendrave të themeluara në nivel të njësisë akademike, performanca e instituteve/qendrave bëhet nga dekani i njësisë akademike, i cili më pas atë e procedon edhe te zyra e rektorit.
3. Në rastin e instituteve/qendrave të themeluara në nivel të universitetit, performanca e instituteve/qendrave bëhet nga zyra e rektorit.
4. Aktivitetet e instituteve/qendrave i nënshtrohen një procesi të rregullt të auditimit të brendshëm të UP-së, auditimit kombëtar, si dhe çdo auditimi tjetër të pavarur (nëse parashihet në kontratë/projekt) për t'u siguruar që shpenzimi i buxhetit është bërë në përputhje me parimet e transparencës, integritetit dhe legjislacionit në fuqi.

## **Neni 20**

### **Ruajtja e të dhënave**

Të gjitha të dhënat që lidhen me funksionimin e instituteve dhe qendrave duhet të ruhen në mënyrë të standardizuar dhe elektronike. Këto të dhëna do të ruhen në bazën qendrore të të dhënave të UP-së dhe të secilit institut/qendër. Baza e të dhënave duhet të përfshijë të dhënat mbi numrin dhe përbërjen e personelit të angazhuar, shifrat buxhetore, të dhënat mbi infrastrukturën, raportet e punës dhe vlerësimet periodike.

## **V. STANDARDET E PUNËS KËRKIMORE**

### **Neni 21**

#### **Pavarësia shkencore**

Të gjitha aktivitetet kërkimore duhet të jenë të pavarura nga ndikimet e jashtme që mund të ndikojnë në cilësinë dhe objektivitetin e punës hulumtuese dhe duhet të kenë transparencë të plotë publike.

### **Neni 22**

#### **Etika dhe integriteti në kërkime shkencore**

1. Të gjitha hulumtimet duhet të zhvillohen në përputhje me standardet etike të hulumtimit shkencor, duke respektuar integritetin, ndershmërinë dhe të drejtat e individëve dhe grupeve të përfshira dhe duke respektuar rregulloret e UP-së si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Të gjitha publikimet dhe produktet e dala nga aktivitetet e projekteve ose shërbimeve në kuadër të instituteve dhe qendrave duhet të kenë përkatësinë (*affiliation*) të institutit/qendrës, njësisë akademike (nëse ka) dhe universitetit.

## **Neni 23**

### **Pronësia intelektuale dhe mbrojtja e të dhënave**

1. Në rast se rezultatet e hulumtimit paraqesin inovacion, instituti/qendra e zbaton procedurën për mbrojtje juridike dhe komerciale të rezultateve të hulumtimit, në pajtueshmëri me kornizën ligjore në fuqi.
2. Bartësi ose ekipi i projektit, në bazë të marrëveshjes kontraktuale me UP-në, ka obligim të autorizojë universitetin t'i ketë dhe t'i përdorë të drejtat e pronësisë intelektuale për komercializim të shpikjes dhe inovacionit dhe për të lejuar kërkimin shkencor të mëtejme, nëse paraqitet nevoja. Autorit i njihet e drejta morale mbi shpikjen apo inovacionin, pavarësisht se kush i zotëron të drejtat komerciale mbi shpikjen.
3. Në rast të arritjes së shpikjes ose inovacionit gjatë punës në një projekt të kërkimit, të mbështetur edhe nga industria, autorizimi për të drejtat e pronësisë intelektuale bëhet në bazë të detyrimeve që dalin prej marrëveshjes paraprake midis subjekteve përkatëse.
4. Në rastet e komercializimit, profiti i nxjerrë prej komercializimit të shpikjes shkencore dhe inovacionit mund të përdorët nga universiteti për investime kapitale, për kërkime të mëtejme, si dhe për shpërbimin e autorëve të tij në bazë të kontratës së dakorduar dhe kornizës ligjore në fuqi.
5. Instituti/qendra është e obliguar të sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale të të gjitha palëve të përfshira në veprimtaritë e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **Neni 24**

### **Situata e konfliktit të interesit**

1. Çdo anëtar i ndonjë strukture organizative të instituteve/qendrave është i obliguar të deklarojë konfliktin e interesit, nëse ekziston një i tillë, në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Kosovës dhe aktet e brendshme të Universitetit të Prishtinës.
2. Menaxhimi efektiv i konflikteve të interesit kërkon transparencë, komunikim të hapur dhe përkushtim ndaj standardeve etike, me qëllim që vendimet të merren në interesin më të mirë të të gjitha palëve të përfshira.
3. Konfliktet e interesit duhet të deklarohen dhe të bëhen publike në të gjitha prezantimet apo botimet e studimeve kërkimore, në mënyrë që të sigurohet transparenca, të ruhet integriteti dhe të forcohet besimi brenda komunitetit shkencor dhe në opinionin

publik, në përputhje me rregulloret e Universitetit të Prishtinës dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

## **VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 25**

#### **Identifikimi me Universitetin e Prishtinës, emërtimi publik i institutit/qendrës**

Në çdo rast dhe formë, pa përjashtim, emërtimi publik i institutit/qendrës duhet të përfshijë, si prapashesë, pas emrit vetanak të institutit/qendrës, emrin e Universitetit të Prishtinës.

### **Neni 26**

#### **Statusi joaktiv dhe shuarja e instituteve/qendrave**

1. Në rastet kur një institut/qendër nuk ka asnjë aktivitet për tre (3) vjet radhazi, instituti/qendra kalon automatikisht në status si institut/qendër joaktive.
2. Në rastet kur një institut/qendër me status joaktiv vazhdon të mos zhvillojë asnjë aktivitet edhe për dy (2) vjet radhazi, pasi që ka marrë statusin e institutit/qendrës joaktive, instituti/qendra gjegjëse konsiderohet automatikisht si e shuar.
3. Institutet/qendrat e shuara duhet t'i nënshtrohen auditimit dhe të gjitha asetet, materiale dhe intelektuale, të një instituti/qendre të shuar i kalojnë automatikisht në menaxhim dhe pronësi të drejtpërdrejtë Universitetit të Prishtinës.

### **Neni 27**

#### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për themelimin dhe parimet e funksionimit të instituteve në Universitetin e Prishtinës „Hasan Prishtina" me numër protokollit 2/513, datë: 25.10.2013.
2. Të gjitha rregulloret e instituteve dhe qendrave ekzistuese duhet të harmonizohen me këtë rregullore, jo më larg se 60 ditë nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

**Neni 28**

**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga kryetari i Këshillit Drejtues të UP-së.

 Këshilli Drejtues,  
  
Alen Sahiti, kryesues